

TÜV NORD CERT

"Conformité EUROPEENNE" CE



Konkurenca ne tregun e Komunitetin Evropian dhe ne tregjet jashte tij imponon prodhuesit te jete gjithmone i perditesuar mbi informacionet e rregulloreve te tregjeve te referimi.

CE Mark

Marka CE është një shkurtim i "Conformité EUROPEENNE" (Konformitetit Evropian) dhe përfaqëson shenjën që produkti është në përputhje me udhëzimet e BE-së dhe standardet përkatëse evropiane të përmendura në Normat Evropiane Në rrugën për Tregun Evropian marka CE është një pjesë e rëndësishme dhe e kërkuar e produktit tuaj. Lëvizja e lirë e mallrave është baza e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian. Objektivi i lëvizjes së lirë të mallrave është parandalimi i kufizimeve të reja në tregti, njohje e ndërsjellë dhe harmonizimin teknik. Marka CE lejon lëvizjen e lirë të mallrave në tregun e BE-së dhe për këtë arsye shenjën CE dhe janë quajtur "pasaportë/biletë për tregun evropian."

Marka CE në etiketën e produktit është një prove që produkti i plotëson të gjitha kërkesat e thelbësore në lidhje me sigurinë dhe



shëndetin në drejtim të direktivave dhe standardeve të harmonizuara të BE-së. Direktivat e BE- Pikeveshtrim i Ri dhe Pikeveshtrim Global përcaktojnë vetëm kërkesat themelore për produkte, ndërsa kërkesat e detajuara teknike janë të përfshira në specifikimet teknike dhe standardet e harmonizuara.

Përputhshmëria me standardet e BE supozon që produkti të jete konform me kërkesat thelbësore të udhëzimeve dhe standarteve teknike.

Duke patur parasysh kërkesat për sigurinë, shëndetin, pastërtinë dhe mbrojtjen e mjedisit, prodhuesi vlereson përshtatshmërinë e produkteve me kërkesat e udhëzimeve dhe standardeve, angazhon Entin e Akredituar TÜV NORD për testimin CE të produkteve. Pikeveshtrimi i ri është një pikeveshtrim modular dhe përcakton modulet e mëposhtme për vlerësimin e jokonformiteteve:

Moduli A: kontrollit të prodhimit të Brendshëm

Moduli B: Ekzaminimi tip CE

Moduli C: Konformitetit ndaj llojit të produktit

Moduli D: sistemit të cilësisë në prodhim

Moduli E: sistemin e cilësisë së produktit

Moduli F: Verifikimi i produktit

Moduli G: Prodhimi individual CE

Moduli H: sigurimi i plote i cilësisë

Zbatimi i certifikimit, përcakton udhëzimet dhe procedurat dhe mund të kryhet nga prodhuesi ose nga një "Ent i Akredituar". Kur në direktive përkufizohet përfshirja me detyrim i një "Enti të Akredituar" Ky i fundit kontrollon dhe shqyrton

cilesine, sistemin e sigurise gjate prodhimit dhe/ose shqyrtimin e produktit perfundimtar per te konfirmuar kerkesat thelbesore ndaj produktit.

Produkti do te miratohet CE vetem pas miratimit nga Enti i Akredituar.

TÜV NORD GROUP është një "Ent i Akredituar" dhe kryen certifikimin e produkteve në fushat e mëposhtme:

- Pajisjet nën presion dhe kontenerë të presionit
- Pajisje Medicinale
- ATEX mbrojtjes Eksploziv
 - Pajisje Sigurie
 - Lojra
 - Pajisje për Saldim
 - Materiale Ndertimi.
 - Etj

Sejcili Enti i Akredituar ka nje numer identifikimi pas Markes CE, nese behet mbikeqyrja e produkteve. TÜV Kroacia TUV NORD GROUP ka numri identifikues ne etikete 0045

Tani për tani, Komisioni Evropian lëshoi 23 udhëzime "Pikeveshtrimit e Ri", dhe katër udhëzime janë në përgatitje. Në varësi të karakteristikave, produkti mund të jetë i permbledhur një udhëzues të vetëm. Udhëzimet janë të ndara në tri grupe sipas kërkesës:

- standardet e harmonizuara evropiane
- në udhëzimet teknike evropiane
- në rregulloret kombëtare teknike.

Duke qene se Shqiperia eshte vend Kandidat ne BE, eshte detyrim per te harmonizimi i ligjeve dhe rregulloreve me ato te BE.

Keshtuqë rregulloret kombetare teknike do te harmonizohen me Regulloret dhe Normat Evropiane.

Prandaj, pritet që një numri i aplikuesve për Marken CE të jete rritje, për shkak të detyrimit që kane prodhuesit dhe eksportuesit në BE për etiketimin e prodhimit me shenjën CE.

Koncepti i "single market & better regulation" i futur per here te pare ne vitet '80 ne tregun e perbashket te BE , ka parashikuar perdorimin e nje pikeveshtrimi me ri per te rregulluar tregjet e brendeshme.

Sot ka mese 22 Direktiva Europiane te cilat mbulojne shumicen produkteve te futura ne tregun evropian , produktet elektroshtepiake , instrumentaat mjekesore, lojrat, makinat, aparaturat elektronike, pajisjet radiofonie , produktet per ndertim dhe sistemet per trenat e shpejtesise se larte..

Sejcila nga keto direktiva parashikon vleresimin e konformitetit te produkteve per ti futur keto te fundit brenda tregut te perbashket.

Kemi percaktuar gjashte faza per markaturen CE te produktit tuaj:

Faza 1: Identifikimi i direktives dhe i normave te harmonizuara te aplikueshme tek produkti juaj

Ka me shume se 22 direktiva qe percaktojne te gjithha kategorite e produkteve qe kane nevoje per Marken CE. Kerkesat kryesore qe produktet duhet te respektojne (p.sh. siguria), jane te harmonizuara ne nivel evropian dhe jane te percaktuara ne terma te pergjithshem ne keto direktiva. Normat Evropiane te harmonizuara jane emeluar duke patur parasysh direktivat e aplikuar te cilat permbajne ne termat teknike, kerkesat baze te detajuara.

Faza 2: Verifikimi i kerkesave specifike te produktit.

Eshte pergjegjesia Juaj te siguroheni qe produkti juaj eshte konform kerkesave baze te Normes perkatese UE.

Konformiteti i plote i nje produkti me normat e harmonizuara, "supozon konformitetin" e tij me kerkesat perkatese baze. Perdorimi i nomave te harmonizuara mbetet vullnetar. Mund te

zgjdhni metoda te tjera per te plotesuar kerkesat baze per nje produkti.

Faza 3: Identifikimi, nese kerkohet vleresimi i pavarur i konformitetit, i nje organizmi i te akredituar.

Ne cdo direktive e cila i perket produktit tuaj, specifikohet nese ne proceduren e vleresimit te konformitetit te domozdoshme per Marken CE duhet te perfshihet nje subjekt i trete i autorizuar (organizem i akredituar). Kjo nuk eshte e detyrueshme per te gjitha produktet, pra eshte e rendesishme te verifikohet nese perfshirja e nje organizmi te tille eshte me te vertete e domozdoshme. Keto organizma jane zyrtarisht te njohur nga Komisioni Evropian dhe te listuata ne database NANDO (New Approach Notified and Designated Organisations – Organizata te njohura dhe te projektuara sipas pikeveshtrimit te ri). TÜV NORD duke qene se eshte i shtrire ne te gjitha vendet e BE ka te gjitha akreditimet e duhura, te shperndara ne te gjitha vendet e BE, per inspektimin dhe finalizimin e Markes CE.

Faza 4: Testimi i produktit dhe verifikimi i konformitetit.

Eshte ne pergjegjesine e prodhuesit testimi i produktit dhe verifikimi i konformitetit me ligje ne fuqi te BE (procedura e vleresimit te konformitetit). Nje pjese e procedures konsiston, sikurse ne pergjithesi, ne vleresimin e rrezeqeve. Duke aplikuar normat perkatese evropiane, fabrikuesi do te jete ne gjendje te permbushet kerkesat baze te direktiveve.

Faza 5: Perpilimi dhe venia ne dispozicion te dokumentacionit teknik te kerkuar.

Prodhuesi duhet te perpiloje Dokumentacionin Teknik te kerkuar nga direktivat per vleresimin e konformitetit te produktit sipas kerkesave te percaktuara dhe per vleresimin e rrezikut. Bashke me deklaraten e konformitetit CE,

dokumentacioni teknik duhet t'i prezantohet, sipas kerkeses, Autoriteteve Kompetente.

Faza 6: Venia e markes CE produktit tuaj dhe deklarata e konformitetit CE.

Markimi CE duhet te vihet nga prodhuesi ose nga nje perfaqesuesi i tij brenda ne SEE (BE+ Norvegjia, Islanda e Liechtenstein) ose Turqia.

Duhet te vihet ne formen e saj Legale, ne menyre qe te jete e shikueshme, e lexueshme, e paheqshme, mbi produktin ose mbi etiketen identifikuese. Nese ne fazen e kontrollit te prodhimit eshte perfshire ndonje organizem i njohur, numri i tij i identifikimit duhet te tregohet.

Eshte pergjegjesia e prodhuesit te perpiloje dhe te firmose nje Deklarate te Konformitetit CE qe te demostroje qe produkti ploteson kerkesat e percaktuara. Me kaq produkti eshte gati per ne treg!

TÜV NORD eshte ne gjendje te ndjeke te gjashte fazat per marken CE te produktit, fale akreditimeve dhe pervojese se gjate ne tregun BE.

Elvis Pazaj

Lead Auditor:

ISO 9001; ISO 14001; ISO 45001

R.A. Soc Resp ISCC EU/GHG Auditor

TÜV NORD CERT GmbH

Systemzertifizierung / System Certification

Am TÜV NORD Bulgaria -TUV NORD GROUP

1005 Tirana,

Albania

M +355 (0)692031015

F +355 (0)445 31015

E epazaj@tuev-nord.de